



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJËNCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	2-D/DPK 02
Nr. Prot. Br.Prot. Prot No.	01-4770/15
Data Datum Date	14.12.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJËNCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllt rasti me nr. AKK-03-02-3433/15, për zyrtarin e lartë z. Fadil Halili, Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3433/15,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Fadil Halili, Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Fadil Halili, Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt, gjatë kontrollit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si pronar dhe person i autorizuar ne ketë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.10.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Fadil Halili, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet.

Zyrtari i lartë z. Fadil Halili, është pajtuar me gjendjen, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bez ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit,pasi qe për ketë çështje nuk ka qen i njoftuar me herët .

Me datën 10.12.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Fadil Halili, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin “N.T.P Agro-Dardania” me numër 80109024.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Fadil Halili, Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt, dukë ber ndryshimet në biznesin privat, duke u larguar nga personi i autorizuar në biznesin e tij, janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shhangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Fadil Halili, Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

